

## Rritja dhe zhvillimi i fëmijës

### Gjithçka që duhet të dimë

Prindi luan rolin kryesor në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, në përshtatje me moshën dhe fazat e zhvillimit. Rritja dhe zhvillimi janë dy terma që i referohen rritjes fizike dhe zhvillimit intelektual të fëmijës. Vitet e para të jetës janë shumë të rëndësishme për një zhvillim të shëndetshëm, i cili nënkupton aftësinë për të plotësuar si nevojat fizike ashtu edhe zhvillimin social, emocional dhe edukimin e tij. Për të arritur këtë zhvillim nevojitet një ambient i ngrohtë dhe i sigurt, dhe shpenzimi i një kohe sa më të gjatë me fëmijën tuaj (duke luajtur, kënduar, lexuar dhe folur).

Ushqyerja e duhur, loja dhe një gjumë i mirë janë elementet kryesore që ndikojnë në zhvillimin e mirë të fëmijës.

### Cilat janë fushat e zhvillimit të fëmijës suaj

Në vitet e fëmijërisë së hershme, fëmijët nuk rriten vetëm në peshë dhe gjatësi. Zhvillimi i tyre përfshin disa fusha si:

- Zhvillimi fizik përfshin zhvillimin e lëvizjeve, ekuilibrin, zhvillimin e aftësive për të përdorur muskujt e mëdhej të trupit (p.sh. muskujt e shpinës, të këmbëve, që janë të nevojshëm për të ecur, për të vrapuar, për t'u hedhur, për të ngjitur shkallët) dhe muskujt e vegjël (p.sh. muskujt e duarve që janë të nevojshëm për të kapur objekte të vogla), ose që ndryshtet zhvillimi i madh motor dhe zhvillimi i motorikës fine.
- Zhvillimi social dhe emocional është aftësia e fëmijës për të krijuar dhe për të mbajtur marrëdhëniet e krijuara me të tjerët. Fëmijët e vegjël mësojnë të bëjnë miq, marrin pjesë në grupet e lojës, tregojnë empati për të tjerët, bashkëpunojnë dhe krijojnë konceptet e dhënies dhe marrjes, zhvillojnë besim, vetëvlerësim dhe kontroll të emocioneve.
- Zhvillimi njoħeis (konjittiv) i referohet aftësisë për të mësuar dhe menduar në shumë mënyra, gjithnjë e më të ndërlikuara. Në vitet e para fëmijët zhvillojnë kuriozitetin dhe mësojnë të bëjnë pyetjet “pse”, “kur”, dhe “ku”. Ata mësojnë të njoħin ngjyrat, gërmat dhe numrat, fokusohen në bërjen e detyrave dhe “zgjidhjen e problemeve”.
- Zhvillimi i komunikimit përfshin aftësinë për të kuptuar gjuhën dhe për të shprehur nevojat, mendimet dhe emocionet nëpërmjet fjaleve. Përgjatë viteve të para të fëmijërisë, fëmijët kalojnë nga gugatja në të folurën e një apo dy fjaleve,
- derisa thonë një fjali të plotë. Ata kanë interes të dëgjojnë histori dhe fillojnë të lexojnë nëpërmjet librave me përralla.

- Aftësia përshtatëse i referohet aftësive zhvilluese të fëmijës për t'u përshtatur me ambientin rrethues dhe për të rregulluar rutinën e përditshme. Në fund të viteve të para, shumica e fëmijëve janë në gjendje të vishen vetë, të hanë, të lajnë dhëmbët dhe të shkojnë në tualet pa ndihmën e të rriturve.

## Foshnja (0-1 vjeç)

### **Gurët kilometrikë (etapat e zhvillimit)**

Aftësi të tilla si hedhja e hapave të parë, buzëqeshja e parë, përshëndetja e parë “paçim -paçim”, janë quajtur gurë kilometrikë, dhe janë veprime që shumë fëmijë i bëjnë në një moshë të caktuar.

Gurët kilometrikë fëmijët i arrijnë nga mënyra sesi luajnë, mësojnë, flasin, sillen dhe lëvizin (p.sh. zvarritja, ecja, hedhja, vrapimi etj.).

Gjatë vitit të parë foshnjat mësojnë të fokusojnë shikimin, të eksplorojnë, të gjejnë dhe të mësojnë rreth objekteve që i rrethojnë. Zhvillimi konjtitiv (njohës) nënkuption procesin e memorizimit, mësimin e gjuhës, të menduarit dhe të arsyetuarit (apo analizuarit të gjërave). Mësimi i gjuhës është një proces më i gjerë sesa thjesht artikulimi i disa rrokjeve “bla-bla”, “mama” “da-da”. Dëgjimi, kuptimi dhe njohja e emrave të njerëzve dhe objekteve është pjesë e zhvillimit të gjuhës. Gjatë këtyre fazave, fëmijët krijojnë marrëdhënie dhe besim me të afërmit, si pjesë e zhvillimit të tyre social dhe emocional.

### **Disa këshilla për të nxitur zhvillimin e fëmijës suaj**

Fëmijët mësojnë dhe zhvillohen nëpërmjet asaj që dëgjojnë, shikojnë, prekin, luajnë, ndiejnë, memorizojnë etj., ndaj ne duhet t'i ndihmojnë ata në këtë proces.

- Flissni me fëmijën tuaj që në ditët e para të jetës - ai e dëgjon zérin tuaj dhe kjo e qetëson.
- Tregoni interes për të (shikojeni në sy, qeshini dhe drejtojuni në emër). Kjo do ta ndihmojë të krijojë marrëdhënie me ju, t'ju besoje dhe të ndihet i sigurt në shoqërinë tuaj.
- Lexojini - kjo do ta ndihmojë atë që të kuptojë sa më shumë fjalë.
- Këndo jini - muzika do ta ndihmojë trurin e tij/saj të zhvillohet.
- Mbajeni në krahë dhe mbështeteni mbi kraharorin tuaj - kjo gjë do t'i japë siguri dhe qetësi.
- Luani me të në momentet që ai/ajo është i qetë dhe vrojtoni me kujdes ndonjë shenjë që tregon se ai është i lodhur dhe kërkon të flejë.

- Kujdesuni gjithashtu pér shëndetin tuaj fizik, mendor dhe emocional. Prindërimi është një detyrë e vështirë, prandaj sa më tē përgatitur tē jeni aq më mirë do t'u përgjigjeni nevojave të fëmijës.

## **Sigurimi i një mjedisit tē sigurt**

Me ardhjen në jetë tē një pjesëtarit tē ri në familje, është shumë i rëndësishëm krijimi i një mjedisit tē pastër, tē qetë dhe pa objekte tē dëmshme që mund tē lëndojnë fëmijën tuaj.

Ja disa këshilla pér tē mbajtur tē sigurt fëmijën tuaj:

- Mos e tundni fëmijën tuaj KURRË! Fëmijët kanë muskuj tē dobët tē qafës, tē cilët nuk arrijnë tē mbajnë kokën, dhe tundja mund tē shkaktojë dëmtim tē trurit (Sindroma e bebes së tundur) që mund tē çojë deri në vdekje.
- Sigurohuni që gjithnjë fëmijën tuaj ta vendosni pér tē fjetur në shpinë, në këtë mënyrë parandaloni Sindromën e Vdekjes së Papritur, e njohur ndryshe si SIDS.
- Krijoni një mjedis tē pastër dhe mos lejoni konsumin e duhanit në ambientet e shtëpisë ku qëndron foshnja.
- Gjatë lëvizjeve me makinë, vendosni fëmijën në sediljen e tij, në sediljen e pasme tē makinës.
- Tregoni kujdes me lodrat që i vendosni pranë pér tē luajtur, pasi lodrat shumë tē vogla apo tē forta mund tē bëhen shkak pér dëmtimin e fëmijës apo mbytjen e tij.
- Mos lejoni fëmijën tē luajë me sende që mund tē mbulojnë fytyrën e tij.
- Mbani larg fëmijëve lëngje tē nxehtha, solucione apo kimikate tē dëmshme pér tē cilat fëmija mund tē tregojë interes pér t'i eksploruar.
- Vaksinat janë shumë tē rëndësishme pér parandalimin e disa sëmundjeve që mund tē bëhen serioze pér jetën e fëmijës. Flisni me mjekun tuaj pér kalendarin e vaksinimit, kohën dhe këshillat pér t'i bërë ato.
- Mos e mbani fëmijën në krevatin tuaj gjatë natës. Vendoseni pér tē fjetur gjithnjë në krevatin e tij/saj, tē pozicionuar pranë krevatit tuaj.

## **Mirëqenia fizike**

Mirëqenia fizike i referohet ndjekjes së rritjes dhe maturimit fizik tē fëmijës, pra ndjekjes së peshës, gjatësisë apo BMI-së (indeksit tē masës trupore). Mjeku juaj gjatë vizitave tē kontrollit tē fëmijës do t'ju informojë rrëth rritjes që ka patur fëmija duke interpretuar kurbat e rritjes.

Pér tē arritur një rritje fizike optimale tē përshtatshme pér moshën e fëmijës, kërkohet një ushqyerje e shëndetshme.

Ushqyerja më e mirë për fëmijën tuaj në 6 muajt e parë të jetës është ushqyerja vetëm me gjitë. Qumështi i gjirit është ushqimi më i mirë për fëmijën tuaj.

Për më tepër rreth ushqyerjes së fëmijës me gjitë, mënyrës së vendosjes në gjitë, sasinë, shpeshtësinë dhe rëndësinë që kjo ushqyerje ka, kërkon ndihmën e mjekut apo infermierit tuaj.